


KOHA PËR AKTIVIZIM



KUPTIMI I FJALËS DEMOKRACI

SHKUMBIN (13), HAMIDE (14), DRENUSHA (13), ERBLIN (14), DRILES (13), ALBINOT (14)


Për të kuptuar domethënien e fjalës demokraci, duhet t'i njohim disa elemente të saj si: të drejtat e njeriut, lirinë dhe barazinë

Secili njeri ka të drejtë të shprehë lirshëm dhe të zgjedh mënyrën e vet të jetesës. P.sh. nëse një individ dëshiron të zgjedh profesionin e tij të caktuar, atij duhet t'i mundësohet e drejta e zgjedhjes së profesionit. Me anë të ligjit, garantohen të drejtat e barabarta. E kush na i mundëson këto të drejta? Këto të drejta na i mundëson demokracia. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke që „demos“ do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Pra, demokracia është formë e qeverisjes, në të cilën udhëheq populli. Forma e parë e demokracisë është shfaqur në Athinë, në vitin 507 p.e.s.




Demokratët

mëri, e cila ndryshe njihet edhe si pluralizëm demokratik.



Atëherë, të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur. Kurse, gratë dhe skllëvërit nuk e kishin këtë të drejtë. Ndërsa, në ditët e sotme, i gjithë populli ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt ose me anë të përfaqësuesve të zgjedhur. Kosova është vend demokratik me sistem parlamentar, ku qytetarët i votojnë deputetët si përfaqësues. Demokracia varet nga interesat dhe pjesëmarrja aktive e qytetarëve. Pasi që çdo shoqëri demokratike ka vlera dhe interesa të ndryshme, ekziston një shumëllojsh-



Ne i respektojmë rregullat e komunikacionit, sepse jemi qytetarë të përgjegjshëm. Bëhuni edhe ju qytetarë të përgjegjshëm si ne për një demokraci sa më të mirë

AKTIVITETET TONA SI QYTETARË AKTIV

RIZA (14), VALENTINA (14), ALTIN (13), KRENARE (13), LINDA (14), ALMEDINA (14)

Të dashur lexues, në artikullin tonë do të informoheni më shumë për aktivitetet që ne si nxënës të klasës së VIII-të i bëjmë çdo ditë, goftë në shkollë apo edhe ato jashtë shkollës

Të qenurit aktiv është një term shumë i gjerë. Kjo sepse çdo ditë kërkohet që të zhvillojmë apo të marrim pjesë në aktivitete të ndryshme. Qëllimi i të cilave, pa dyshim që është e mira e përbashkët e të gjithë vendit. Cilat janë këto aktivitete, në bazë të së cilave mund të cilësohemi si qytetarë aktiv? Përgjigjen mund ta merrni në këtë artikull. Mirëpo, fillimisht duam t'iu tregojmë se kush quhet qytetar. Që më pastaj të kuptojmë më mirë edhe vetë konceptin e qytetarisë aktive. Qytetar e quajmë çdo njeri, i cili është i regjistruar në regjistrin civil. Ndërsa, qytetarë aktiv i quajmë të gjithë ata persona të cilët janë gjithmonë aktiv, përmes aktiviteteve të ndryshme. Si për shembull, ata qytetarë të cilët marrin iniciativa për t'i vetëdijësuar personat e tjerë, të cilët nuk kanë shumë informata rreth temës

së aktivizimit, e shumë të tjera.

Në shkollën tonë, shumica e nxënësve jemi nxënës shumë aktiv. Pothuajse çdo muaj, organizojmë aktivitete për pastrimin e ambientit shkollor. Përpos shkollës, ne po ashtu organizojmë edhe aktivitete për pastrimin e fshatit tonë, Ramjan.


Si dhe aktiviteti i fundit që ne kemi zhvilluar ka qenë në qytetin e Vitisë. Aty kemi diskutuar këto tema: ngrohjen globale, mbrojtjen e mjedisit, dëmtimin e shëndetit përmes pirjes së duhanit, si dhe për bimët e ujin. Mbi këto tema, ne i kemi vetëdijësuar qytetarët e Vitisë për nder të Ditës së Tokës me 22 prill. Ne e kemi arritur qëllimin tonë. Kemi arritur t'i bëjmë qytetarët e Vitisë të kuptojnë rëndësinë që ka ambienti në shëndetin e gjithë neve.



Këto mjete të punës, i ka vizatuar shoku ynë Altini



Qytetaria aktive nuk kërkon moshë, ajo kërkon aktivistë




Këtu kemi paraqitur popullin i cili është Dielli. Ndërsa, tek rrushi kemi shkruajtur disa aktivitete të cilat qytetarët aktiv i bëjnë. E tërë kjo, për një jetë sa më të mirë



Buzëqeshja në fytyrat tona tregon se me sa shumë dashuri dhe bashkëpunim e kemi shkruajtur këtë artikull. Lexojeni edhe ju, sepse është i dobishëm



Një nga disa vlera të shumta, që ne sot si nxënës të klasës së VIII-të i përçuam ishte pa dyshim bashkëpunimi



Punën e morëm me shumë përkushtim



Intensiteti i njëjtë i punës ishte tek secili grup



Nuk mund ta lëmë pas as lumturinë dhe gëzimin që sot e përjetuam



Tash, ti i dashur lexues, e ke radhën për të përjetuar përvojën që e patëm sot

KUVENDI, INSTITUCION ME SHUMË PËRGJEGJËSI

FLORDA (14), ERONITA (14), DIELLONA (14), DENIS (14), LIRIK (14), LENART (14)

POPULLI VENDOS



Qytetarë të dashur, a jeni kureshtarë të dini se cili është ai institucion që merr vendime në të mirë të popullit?

Me kënaqësi, ju njoftojmë se ky institucion i cili merr vendime në të mirën e popullit është Kuvendi. Deputetët, të cilët punojnë në Kuvend janë përfaqësuesit e zgjedhur nga populli, për marrjen e vendimeve. Në Kuvendin e Kosovës janë gjithsej 120 deputetë. Këta deputetë kanë të drejtë të propozojnë projektligje. Më pas, i votojnë ato, në mënyrë që të miratohen dhe të bëhen ligje. Përfituesit më të mëdhenjë të ligjeve janë qytetarët. Ata me vullnetin e tyre, ua kanë besuar fuqinë që kanë deputetëve, në mënyrë që ata t'i miratojnë ligjet. Sikur të mos ishin ligjet për arsim ne do të ishim në humbje të madhe, sepse nuk do të kishte zhvillim në vend. Vlerë të madhe kanë të gjitha ligjet, por ne përmendëm ligjet për arsimin për arsye se këto ligje ndikojnë shumë tek ne nxënësit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës ka shumë detyra dhe përgjegjësi, siç janë: përfaqësimi i popullit, miratimi i ligjeve dhe kontrollimi i Qeverisë. Po ashtu, Kuvendi zgjedh Qeverinë dhe Presidentin e vendit. Në Kuvend zhvillohen seancat plenare, të cilat udhëhiqen nga Kryetari i Kuvendit. Ai, së bashku me kryesinë e Kuvendit, cakton pikat e rendit të ditës. Vlen të theksohet se Kuvendi edhe zbaton parimet e demokracisë, si: shprehja e mendimit, barazia, respekti, toleranca, etj. Këtij institucioni punën edhe më shumë ia lehtëson populli, duke i zbatuar ligjet e miratuara në Kuvend. Prandaj, ne qytetarët duhet të vetëdijësohemi edhe më shumë për rolin që kemi në një shtet demokratik. Vetëm duke qenë qytetarë aktiv do të arrijmë të përmirësojmë të ardhmen tonë dhe të sigurojmë një jetë edhe më të mirë për të gjithë. Vlera jonë është shumë e madhe, prandaj mos ta nënvlerësojmë atë! Së bashku mund të bëjmë ndryshime.



Jam i lirë për të zgjedhur personat që unë dua



Ne jemi e ardhmja e Kosovës



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Skender Emërllahu“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Ramjan, Viti